

**Protokoll për veprim të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut
për realizimin e procesit edukativo-arsimor me prani fizike të nxënësve në vitin
shkollor 2021/2022**

1. Procesi mësimor në vitin shkollor 2021/2022 zhvillohet me prani fizike në shkollë.
2. Dita e parë e mësimit detyrimisht fillon me udhëzime për nxënësit mbi atë si mënyrën e drejtë dhe të sigurt të sillen, të mbajnë distancë fizike, higjenën e duarve dhe mbrojtjen e shëndetit personal por edhe shëndetin e nxënësve tjerë dhe punonjësve në shkollë.
3. Shkolla për hyrje dhe dalje të nxënësve i vendos në funksion të gjitha hyrjet e objektit shkollor
4. Në hyrje të shkollës, në korridoret dhe klasat vendosen materiale edukativo-informuese, udhëzues për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në shkollë dhe mjete për dezinfektimin e duarve.
5. Hyrja në shkollë lejohet vetëm me përdorimin e detyrueshëm të maskës mbrojtëse dhe dezinfektimin e duarve për të gjithë punonjësit dhe nxënësit në shkollë. Gjatë pushimit të madh mbajtja e maskave në ambient të hapur nuk është e detyrueshme, por me respektimin e distancës së nevojshme ndërmjet nxënësve.
6. Nxënësit me nevoja të veçanta ose me vështirësi në zhvillim, tek të cilët mbajtja mbrojtëse personale e fytyrës që gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor do të ishte problematike ose e kundërindikuar, të jenë të liruar nga mbajtja mbrojtjes personale (maskë mbrojtëse), me vërtetim mjekësor të dorëzuar paraprakisht nga mjeku.
7. Në çdo hyrje të shkollës nxënësit i pret mësimdhënësi kujdestar i cili i ndihmon nxënësit të dezinfektojë duart me dezinfektues.
8. Për hyrje dhe dalje të kontrolluar në /nga shkolla, para dhe brenda në shkollë, organizohet shërbim për mbajtjen e rendit, me qëllim zbatimin e mbajtjes së rendit dhe mbajtjes së distancës së nevojshme në mes nxënësve. Gjatë pushimit të madh, mbajtës të rendit organizohen edhe në oborrin e shkollës. Mbajtësit e rendit angazhohen nga stafi i punonjësve në shkollë, për të cilët vendos drejtori i shkollës fillore.
9. Nxënësve të cilët udhëtojnë me transport të organizuar, u matet temperatura para hyrjes në autobus dhe bëhet dezinfekimi i duarve dhe këpucëve, Nxënësit që kanë temperaturë të rritur (mbi 37.4°) kthehen në shtëpi me rekomandim që prindi të marrë masat e duhura shëndetësore. Transportuesit të cilët kryejnë transportin e nxënësve i respektojnë dhe zbatojnë protokollet për transportin e udhëtarëve.
10. Të gjithë punonjësve ju matet temperatura trupore para hyrjes në shkollë me termometër digjital pa kontakt fizik, ndërsa në rast të rritjes së temperaturës (mbi

37.4°) punonjësi drejtohet tek mjeku amë.

11. Nxënësve para hyrjes në shkollë, Ju matet temperatura trupore me termometër digital pa kontakt fizik. Në rast të rritjes së temperaturës trupore (mbi 37.4°) nuk lejohet hyrja e nxënësit në shkollë ndërsa prindi drejtohet për konsultim tek mjeku amë i nxënësit. Fëmijët me simptoma të sëmundjeve tjera ngjitime gjithashtu nuk duhet të lejohen të shkojnë në shkollë.

12. Prindërit / kujdestarët i dërgojnë nxënësit deri të hyrja e caktuar e shkollës dhe ndalohet hyrja e tyre në shkollë, përveç për prindërit/ kujdestarët dhe asistentët arsimor të nxënësve të cilët janë me nevoja të veçanta arsimore me mbajtjen e obligueshme të maskës/ mbulimin e fytyrës.

13. Ndalojen të gjitha përshëndetjet me kontakt fizik ndërmjet punonjësve në shkollë dhe ndërmjet nxënësve.

14. Mësimdhënësit duhet t'iu shmangin qëndrimeve të gjata në zyrën e mësimdhënësve, dhe detyrimisht kujdesen për distancën fizike dhe mbajtjen e maskës mbrojtëse. mbulimin e fytyrës.

15. Shkëmbimi i informatave dhe takimet me prindërit/ kujdestarët zhvillohet përmes telefonit ose përmes aplikacionit online për të cilën do të bien dakord prindërit dhe mësimdhënësit, ose nëse lejojnë kushtet e motit në natyrë.

16. Hapësirat të cilat më së shpeshti janë të ekspozuar ndaj prekjes, nga ana e punonjësve në shkollë dhe nxënësve, dezinfektohen në fillim dhe në fund të çdo ndërrimi më së paku dy herë në ditë. Shkolla përgatitë listë për të gjitha hapësirat të cilat rregullisht duhet të pastrohen;

17. Hapësirat detyrimisht të ajrosen pas përfundimit të çdo ore mësimore, më së paku gjysmë ore para ardhjes dhe pas shkuarjes së nxënësve.

18. Gjatë orës së mësimit në klasë, nëse lejojnë kushtet klimatike preferohet që dritarja të jetë e hapur. Në klasat (nëse shkolla disponon) rekomandohet që të shmanget shfrytëzimi i koncicionerëve dhe ventilimit.

19. Pastrimi i klasave bëhet para fillimit të mësimit, gjatë kohës së pushimit kur nxënësit janë në oborrin e shkollës dhe pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve, me ujë dhe sapun/ detergjent dhe me mjete dezinfektuese të cilët veprojnë ndaj virusave sipas udhëzimeve të prodhuesit.

20. Përdorimi i tualetave organizohet në mënyrë që të mundësohet prani më e vogël e nxënësve dhe mbajtja e distancës (p.sh. nëse tualeti është i vogël nxënësi duhet të pres jashtë tualetit derisa të dalë nxënësi i cili gjendet brenda).

21. Tualetet duhet të janë funksionale në mënyrë që të sigurojnë kushte përlarjen më të shpeshtë të duarve me ujë dhe sapun dhe më shpesh të pastrohen duke mbajtur shënimë të obligueshme për pastrimin dhe dezinfektimin me mjetet të cilat veprojnë ndaj virusave sipas udhëzimeve të prodhuesit në mënyrë alternative mund të përdoret hipoklorit të natriumit 0.5 % (5% zbardhues për amvisëri i cili përdoret në raport 1:100) ose 70 % alkool për dezinfektimin e hapësirave të sipërme.

22. Sallat, shkallët dhe hapësirat tjera të përbashkëta pastrohen më së shpeshti, derisa nxënësit janë në mësim dhe pas përfundimit të të gjithas aktiviteteve shkollore.

23. Pastrimi i sallës së fizkulturës dhe fushave sportive, zhveshtoreve, dhomave

për ngrënie dhe

hapësirave tjera ndihmëse, bëhet menjëherë pas shfrytëzimit të çdo grupei të nxënësve.

24. Në shkollat fillore ku ka qëndrim të zgjatur, është e nevojshme i njëjtë të organizohet në korniza të kapaciteteve hapësinore të disponueshme dhe të realizohet me nxënës të së njëjtës paralele dhe të së njëjtës klasë.

25. Ushqimi i përgatitur në kuzhinat e shkollës përfshin fëmijët me qëndrim të zgjatur, duhet të jetë në përputhje të plotë me respektimin e rregullave përfshin praktikë higjenike dhe të prodhuar, të përcaktuar me Ligjin përfshin Sigurim të Ushqimit, si dhe standardet dhe Protokollet e HACCP përfshin mbrojtje nga KOVID-19.

26. Shfrytëzimi i sallës së fizkultrës, bibliotekës dhe hapësirave tjera duhet të bëhet nga grupei i

nxënësve të të njëjtës paralele, në mënyrë që të mos ekzistojë mundësia e përzierjes së një numri të madh të nxënsëve nga paralelet e ndryshme.

27. Duhet të shmanget hyrja e personave të tjerë (p.sh, pastrim, riparim ose sjellje të ushqimit) nëpër klasa derisa nxënësit gjenden aty, si dhe hyrja në objektin shkollor të personave të cilët nuk janë të punësuar në shkollë ose fëmijë që nuk janë nxënës të asaj shkolle, me përjashtim të përfaqësuesve të MASH, BZHA, ISHA ose organe tjera shtetërore të cilat zbatojnë mbikëqyrje mbi zbatimin e rregullave dhe ligjeve nga fusha e arsimit dhe mbrojtja shëndetësore.

28. Dërgesat përfshin nevojat e shkollave i marrin përgjegjësit, punonjësit në shkollë nga hyrja dytësore e shkollës (nëse ekziston një hyrje e tillë), ndërsa hyrja kryesore lejohet vetëm përfshin tekniket e shërbimeve ose ofruesit tjerë të shërbimeve të cilat janë të domosdoshëm (p.sh. zbatimi i masave parandaluese dhe masave epidemiologjike siç janë kontrollimi i ujit të konsumueshëm, siguria e ushqimit etj) me respektimin e detyrueshëm të masës përfshin dezinfektimin e duarve si dhe mbajtja e maskës mbrojtëse/mbulesës së fytyrës dhe mbrojtës së këpucëve.

29. Nëse në shkollë paraqitet ndonjë person i sëmurë me KOVID -19 ose person i cili ka pasur kontakt me të sëmurë me KOVID -19, personi duhet të izolohet në hapësirë të veçantë me mbajte të obligueshme të maskës/ mbulimit të fytyrës, ndërsa drejtori duhet të komunikojë me Qendrën përfshin Shëndet Publik përfshin marrjen e udhëzimeve përfshin tjetra të mëtutjeshëm. Përfshin aktivitetet e ndërmarrja dorëzohet raport në komunë, ndërsa komuna në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

30. Nëse nxënësi shfaq simptoma të KOVID-19 deri sa është në shkollë mësimdhënësi/bashkëpunëtori profesional izolon nxënësin në hapësirë të veçantë dhe menjëherë i njofton prindërit / kujdestarët , të cilët në periudhë sa më të shkurtër kohore duhet të marrin fëmiun me qëllim të konsultimit dhe veprimit të mëtutjeshme me mjekun amë të nxënësve.

31. Nëse konfirmohet se nxënësi është i sëmurë me KOVID -19, njoftohet shërbimi epidemiologjik në Qendrën përfshin Shëndet Publik i cili urgjentisht duhet të realizojë pyetësor me mësimdhënësit dhe nxënësit përfshin vlerësimin e nivelit të rrezikshmërisë në bazë të kontakteve të cilat i kanë pasur

Kujtesë: Ky protokoll vlen edhe për shkollat fillore shtetërore (shkolla me qendra burimore , shkolla me qendra burimore dhe akomodim në konvikte, shkolla shtetërore për muzikë dhe balet), me masa plotësuese për mbrojtje nga KOVID-19 në pajtim me specifikat e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe shërbimet të cilat i dorëzojnë.